

MIRATOHET
PËR KKTKM
Sekretari i KKTKM
SOKOL ISMAILI

RELACION PROJEKTI
Restaurimi i Xhamisë së Allajbegisë
fshati Burim, Dibër



Përgatiti: Elina Manushi
Vilma Hashorva

TIRANË 2024





Restaurimi i Xhamisë së Allajbegisë, Burim, Dibër

PËRMBAJTJA

1. VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI HISTORIK	3
2. PËRSHKRIMI DHE ELEMENTËT ARKITEKTONIKË	4
3. TEKNIKA E NDËRTIMIT	12
4. GJENDJA E KONSERVIMIT E KISHËS	13
5. NDËRHYRJET E PROPOZUARA	15

1. VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI HISTORIK

Fshati Burim, është një fshat i vogël malor, në njësinë administrative Maqellarë, në Bashkinë e Dibrës, që pozicionohet në skajin më jug-lindor të kësaj bashkie, fare pranë kufirit të Shqipërisë me Maqedoninë, në malin Deshat. Xhamia e Allajbegisë ndodhet pothuaj në qendër të fshatit. Ajo është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së Parë me Vendim nr. 68/7, datë 30.05.1970 nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejt. Kulturës) dhe riaprovuar me Vendim nr. 1886, datë 10.06.1973 nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës. Askesi për në monument është fare i lehtë pasi ndodhet në qendër të fshatit dhe pranë rrugës automobilistike.

Monumenti është ndërtuar në një terren të sheshtë, në një parcelë në formë të stërgjatur që pozicionohet në qendër të saj dhe të rrethuar me kangjella metalike. Hyrja për në oborr bëhet nga veriu nëpërmjet një porte hyrëse të lartë. Pavarësisht terrenit të sheshtë dhe të lehtë për t'u mirëmbajtur, oborri përreth xhamisë nuk është i sistemuar. Duke parë gjeometrinë e parcelës dhe mundësinë e saj do të ishte mirë që oborri përreth xhamisë të trajtohej në formën e një kopshti hyrës.

Monumenti i përket shekulli XVI dhe është i tipit sallë me kupolë, me një volum kubik, që karakterizohet nga salla e lutjeve me mure perimetrale me teknikën e kluasonazhit dhe i mbuluar me një kupolë ngritur mbi një tambur tetëfaqësh dhe çati me tjegulla. Përveç sallës së lutjeve në anën veri-perëndimore ka pasur dhe një hajat, nga i cili kanë ngelur vetëm themelet e mbi të cilin sot është ringritur struktura me teknikë moderne. Po ashtu në anë veri-perëndimore gjendet edhe minareja, e cila është rindërtuar vonë. Hyrja bëhet nga veri-perëndimore nga dera e vetme. I gjithë interieri i xhamisë është i suvatuar dhe lyer me bojë të bardhë.



Aktualisht, Salla e lutjeve, ruan të gjithë elementët origjinal, si teknikën e ndërtimit, mbulimin me kupolë dhe çati me tjegulla, ndërsa hajati dhe minareja, janë ndërtime më të reja, të cilat janë realizuar rreth viteve 1990 dhe janë plotësisht të tjetërsuar. Referuar A. Meksit, Minareja mendohet të jetë shkatërruar rreth vitit 1967. Nga kjo minare, ruhej vetëm bazamenti oktagonale deri në një lartësi rreth 6 m, që sot është lehtësisht i dukshëm për nga teknika e ndërtimit me gurë, ndërsa pjesa tjetër e shtuar është realizuar me strukturë beton/armeje. Gjithashtu edhe hajati ka pësuar disa herë ndryshime, pasi në fotografi të viteve 1968 dhe 1970 ai rezulton të jetë një ndërtim i thjeshtë një katësh, mbuluar me çati (fig. 2). Më vonë, ai duhet të jetë prishur, për shkaqe të paditura. Bazuar në dokumentacionin arkivor, gjenden rilevime të vitit 1975 të themeleve të kësaj zone (fig. 3) (rilev. L.Suli), ku planimetria e tyre të bën të mendosh se edhe hajati i vitit 1970 nuk duhet të ketë qenë origjinali. Duke bërë krahasimin me tipologji të ngjashme si dhe duke vëzhguar fotot e vjetra ku vihen re gjurmët në fasadë, mendohet se hajati ka qenë përherë një ndërtim më i ulët dhe më i thjeshtë se ndërtesa kryesore, me konstruksion më të lehtë dhe me mbulim me çati druri, prandaj ka qenë subjekt i prishjeve të herëpashershme. Deri në vitet 1980, xhamia rezulton të mos ketë pasur hajat. Rindërtimi i tij, nga informacioni i banorëve mendohet të jetë realizuar rreth viteve 1990, dhe nga forma e planimetrisë dhe organizimi është plotësisht i ndryshëm nga hajati i 1970 dhe i themeleve të dokumentuara (fig. 4). Përveç ndërhyrjeve të ndryshme në elementët e strukturës, në monument janë kryer përherë punime mirëmbajtëse, përgjithësisht në çatinë e tij, në elementët drusorë (dritare, dysheme, elementët e interiorit). Në 1973 janë kryer punime të plota restauruese nga A. Meksi, për të cilat është bërë edhe artikulli nga autori. Ndërhyrjet kanë konsistuar në një studim të thellë të ndërtesës, ndërhyrje në çati, plotësime të muraturës, fugatime, plotësimi i kornizave nën çati, etj.




Figura 2 – rilevim viti 1970




Figura 3 - rilevim viti 1973




Figura 4 – rilevim viti 2024

Kronologji e dokumenatacionit arkivor të IKTK-së

- 1967** – Sipas A. Meksi, mendohet të jetë shkatërruar minareja (bibliografi - A. Meksi)
- gusht 1968** - Dokumentuar me fotografi pa minare dhe me hajat (R. Veseli)
- 1970** - Dokumentuar grafikisht pa minare dhe me hajat (B. Strazimiri)
- korrik 1973** - Dokumentuar me fotografi dhe grafikisht pa minare dhe pa hajat (S. Metuli) si dhe janë kryer ndërhyrje restauruese (autor A. Meksi)
- 1975** - Rilevime të themeleve të hajatit (L. Suli)
- mars 1977, 1979** – Dokumentuar me fotografi pa minare, pa hajat ('77 M. Baba, '79 V. Shtylla)
- korrik 1980** - Dokumentuar me fotografi pa minare dhe pa hajat (L. Suli) si dhe janë kryer ndërhyrje mirëmbajtëse në çati dhe korniza nën-çati (autor A. Meksi)
- 1982** - Dokumentuar me fotografi pa minare dhe pa hajat (L. Suli)
- 1986** – Relacion përshkrimor (A. Meksi)
- 1990** - Minareja dhe hajati mendohet të jenë realizuar rreth vitit 1990 të dyja (informacion nga banorët)
- 2007** – Projekt ide restaurimi (V. Shehu)
- 2008** – Hartim projekti IMK (R. Çuku), me minare dhe hajat
- 2018** - Hartim projekti DRKK Shkodër (Ç. Gjuraraj, S. Kuçi, F. Hoxha), me minare dhe hajat
- 2021** - Hartim projekti IKTK, me minare dhe hajat



Foto e hajatit nga ana perëndimore, viti 1968 (R. Veseli)



Foto e fasadës jugore dhe lindore, viti 1968 (R. Veseli)



Foto e fasadës hyrëse, korrik 1973 – gjatë restaurimit (A. Meksi)



Foto e fasadave veriore dhe perëndimore, mars 1977 (M. Baba)




Foto e fasadës hyrëse - korrik 1982 (L. Suli)

2. PËRSHKRIMI DHE ELEMENTËT ARKITEKTONIKË

Forma planimetrike e xhamisë është e ndarë në dy ambiente: Salla e lutjeve dhe hajati. Mbulimi i të gjithë xhamisë është realizuar me tjegulla duke ndjekur formën e kupolës. Dimensionet e jashtme janë 15.08 m x 10.42 m.

SALLA E LUTJEVE me plan katror, ka dimensione të brendshme 6.20 m x 6.40 m. Sa hyn në ambient përballë ndodhet mihrobi, i realizuar si një nikje gjysëmrrethore dhe e mbuluar me qemer në formë fundlunde. Nga ana veriore, mbi hyrje në kuotën +1.90, ndodhet një mafil prej druri, i cili mbështetet vetëm në një kollonë ngjitur me murin dhe mbi një tra druri të fuqishëm i cili kapet në dy anët e ambientit. Kalimi në mafil bëhet nga shkallët e minaresë.



Pamje e sallës së lutjeve

Mbulimi i sallës bëhet me kupolë të ngritur në një tambur 8-faqësh, e cili shkarkon në tamburet anësorë, e më tej në muret perimetrale. Lartësia e brendshme, nga dyshemeja deri në kulmin e kupolës është 8.65 m, ndërsa ajo e tambureve nga dyshemeja është +4.53 m. Ndriçimi i sallës është i bollshëm, pasi në të gjitha faqet ndodhen nga 3 dritare, dy në kuotën +0.48 m dhe 1 në kuotën +3.93 përveç fasadës veri-perëndimore, mur që e ndan me hajatin, e cila ka 1 dritare në brezin e poshtëm dhe derën hyrëse. Të gjithë muret e brendshme dhe kupola janë të suvatuara dhe lyera me bojë të bardhë.



Pamje e mafilit

MINAREJA

Në anën veri-perëndimore ndodhet minareja me një sheref, e mbuluar me çati plumbi, me një lartësi totale 23 m. Bazamenti i saj, i cili i përket fazës së ndërtimit të xhamisë, është realizuar me muraturë guri të bardhë të skuadruar, i cili vjen dhe ngushtohet për të krijuar volumn e minares, dhe ndërfutet në vëllimit të xhamisë. Pjesa e sipërme është një ndërtim i ri me beton, i realizuar pas prishjes së minares.



Pamje e minaresë

DYERT

Duke qenë një xhami e vogël, ajo ka vetëm një derë hyrëse e cila pozicionohet në fasadën veri-perëndimore. Konstruksioni i portës është me mbulim me arkitra guri dhe me një qemer lehtësues në formë fund lundre. Dera është prej dur-alumini, dy kanatëshe, qartësisht e vendosur.



Porta hyrëse në fasadën veri – perëndimore



Dritarja në fasadën veri - perëndimore

DRITARET

Xhamia ka 10 dritare, nga 3 në secilën nga fasadat (jug, lindje, perëndim) dhe 1 në fasadën veriore. Dritaret janë prej druri dy kanatëshe, dhe nga jashtë janë të mrbojtura me kangjella hekuri. Ato në fasadë kornizohen nga korniza guri e mbi të cilat ndodhen harqet lehtësuese, ku pjesa e brendëshme realizohet pak më e futur në formën e një nikjeje. Vetëm dritarja e faqes veriore mbi arkitraun është realizuar me një tip qemeri lehtësues me shkallëzim.

DYSHEMEJA

Dyshemeja e sallës është e shtruar me çimento e mbi të është ngritur niveli rreth 10 cm me një dysHEME druri, e cila sigurisht që nuk është origjinalja, por është ndërhyrje e bërë gjatë viteve. Niveli i dyshemesë është rreth 10 cm mbi nivelin e sistemit të jashtëm.

KUPOLA

Xhamia është e mbuluar me kupolë dhe e suvatur dhe lyer me të bardhë. Nën lyerje evidentohe piktura, të cilat sipas informacionit të marrë gjatë inspektimit duhet të jenë bërë vonë dhe nuk janë të periudhës së ndërtimit të xhamisë.



Pamje e dritareve



Pamje e dritareve



Pamje e mafilit

HAJATI

Ne realitet ne pozicionin ku do te ndertohet hajati eshte nje objekt 1 kat me cati ne gjendje te degraduar.

Kjo strukture nepermjet te ciles kalon ne hyrjen kryesore te xhamise eshte menduar te priset dhe ne po te njejtin pozicion duke ruajtur bazamentin do te ndertohet hajati.

Hajati do te mbulohet me cati druri dhe do te jete nje ambjent ne funksion te xhamise.

3. TEKNIKA E NDËRTIMIT

Xhamia, i përket tipologjisë së xhamive të vogla sallë me kupolë dhe karakterizohet nga një volum kubik i realizuar me teknikën e kluasonazhit. Muret janë të ndërtuar me dy rreshta tullash horizontal dhe dy vertikal, me gurë të lidhur me llaç gëlqere e të vendosur në rreshta horizontale. Fasadat sot është e pa suvatuar nga jashtë, përveç fasadës veri-perëndimore, që i përket ambientit të mbyllur të hajatit dhe që është e suvatuar dhe e lyer, ndësa brenda ambienti është i gjithi i suvatuar. Në pjesën e kupolës evidentohet gjurmë të pikturës murale, e cila duhet të jetë realizuar vonë. Trashësia e muraturës është 95 cm.

Mbulimi i saj realizohet, me çati me tjegulla. Salla e lutjeve ka mbulim me kupolë ngritur mbi një tambur 8faqësh, i cili nuk del jashtë kupolës dhe është i suvatur nga brenda. Dritaret e rreshtit të poshtëm janë realizuar me korniza guri e sipër tyre me qemerë lehtësues me tulla në formë fund lundre, kornizuar në pjesën e sipërme me një rresht tullash e të mbyllur me muraturë përsëri me tulla, si nikje. Dritaret e rreshtit të sipërm janë me qemer me tulla, më të ngushta e të pakornizuara. Në mjaft vende në pjesën e sipërme të volumnit vihen re plotësime të muraturës të realizuara më vonë dhe që ndryshojnë nga teknika origjinale e xhamisë, ndërhyrje këto që kanë ardhur si pasojë e dëmtimeve apo ndryshimeve të lartësive të mbulimit. Bazamenti i minaresë është realizuar me gurë të skuadruar të bardhë të cilët ndërfiten me muraturën në cepin veri-perëndimor. Kreu i muraturës është i kornizuar me dy ose një rreshta tullash të vendosura në formë dhëmbë-sharre.

4. GJENDJA E KONSERVIMIT E KISHËS

Sipas dokumentacioneve dhe inspektimit në vend, ndërtesa ka pësuar dëmtime nga tërmeti i vitit 1967, në të cilin mendohet të jetë shkatërruar minareja dhe hajati, por volumni kryesor nuk duket se ka shfaqur probleme serioze në të kaluarën. Aktualisht, gjendje strukturore e xhamisë është shumë të mirë, për nga ana statike dhe nuk paraqet probleme me lagështinë apo dëmtime të dukshme. Për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit monumenti ka vetëm nevojë për disa ndërhyrje mirëmbajtje në çati dhe elementët drusorë si dhe në sistemin përreth. Gjendja e konservimit aktuale për elementë specifike është si më poshtë:

1. SALLA E LUTJEVE

- **MURATURA** nga brenda është në gjendje të mirë. Ajo është e suvatur dhe e lyer, ndërsa i gjithë perimetri deri në nivelin e dritareve të rreshtit të poshtëm është e veshur me pllaka qeramike.
- **DYSHEMEJA** është prej druri dhe ka nevojë për restaurim.
- **KUPOLA**. Struktura e tij është në gjendje të mirë dhe nuk evidentohen çarje, por dëmtimi dhe mungesa e tjegullave ka sjellë prezencën e lagështisë me zverdhe të suvasë dhe ndonjë shkoputje të rrallë të saj.
- **MINARJA** nga evidentimet dukej në gjendje të mirë. Gurët e bazamentit të saj janë të lyer me sherbet gëlqere.
- **FASADA** ka dëmtime të fugave dhe përdorimi jo korrekt të materialit lidhës.

2. **HAJATI** është një Shtesë 1 katëshe e realizuar rreth viteve 1990, me çati llamarine dhe strukturë me muraturë tulle. Kjo strukturë do të prishet dhe do të ruhet vetëm bazamenti dhe do të mbulohet me cati dhe rrethuar me parmace druri.

3. **ÇATIA** është në gjendje të degraduar dhe depërton lagështi në brendësi. Evidentohet edhe prezencë vegjetacioni. Në çati janë kryer punime restauruese në vitet e fundit.

4. DYERT DHE DRITARET

- Dera prej dur/alumini por është relativisht e re dhe funksionale
- Degradim i elementit drusor në dritare



Restaurimi i Xhamisë së Allajbegisë, Burim, Dibër

5. *STRUKTURA* e xhamisë është në gjendje mjaft të mirë dhe nuk paraqet probleme strukturore. Nuk u evidentuan problematika në muraturë dhe mbulim.

6. *DRENAZHIMI DHE SISTEMIMI PËRRETH*

- Sistemimi përreth ka nevojë për pastrim nga barërat e këqija dhe vegjetacioni
- Aktualisht prona është e rrethuar me kangiella metalike, në gjendje të degraduar.
- Mungon një rrugë kalimi që të drejton për në xhami.

8. *SHKAKU I DEGRADIMEVE*

- Vjetërsia e objektit
- Nevoja për mirëmbajtje të herëpashershme

5. *NDËRHYRJET E PROPOZUARA*

Ndërhyrjet e propozuara do të konsistojnë si më poshtë:

SALLA E LUTJEVE

F.V dyshemesë së drurit

Ndërhyrje në cati

Trajtimi i elementëve të drurit me vaj lini dhe antimol

Riparim, suvatimi dhe retukim i pjeseve të dëmtuara të suvase me llaç gelqere

DERA DHE DRITARET

F.V. dyer/ dritare sipas modelit ekzistues

ÇATIA

Heqje e tjegullave të dëmtuara, izolim i kupolës me llaç horasan dhe vendosje e tjegullave të vendit

Pastrime nga vegjetacioni në çati

FASADA

Pastrimi i materialit lidhës dhe realizimi me kujdes i fugaturës

Larje dhe pastrimi i gurëve të bazamentit të minaresë

PRISHJE E STRUKTURES EKZISTUESE

Prishje mur tulle
Prishje catie

NDERTIM CATI DRURI

Ndertim catie me tjegulla ne struktura te kurbezuara
F.V Parmake druri
F.V Binare druri dhe trare druri

SISTEMIM DHE DRENAZHIM

Shtrim kalldremi
Drenazhim mbushje me rere

Vilma
Hashorva

Digitally signed by
Vilma Hashorva
Date: 2024.10.22
14:32:24 +02'00'

Elina
Manushi

Digitally signed by Elina
Manushi
Date: 2024.10.22
14:42:03 +02'00'

